

VENDIM
Nr. 683, datë 28.9.2016

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT
“ANSAMBLI I RILINDJES URBANE, BELSH”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe të ligjit nr. 160/2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Ansambli i Rilindjes Urbane, Belsh”.
 2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Belsh.
 3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë “tokë truall”, “objekt shërbimi” dhe “objekt banimi”, me një vlerë të përgjithshme të shpronësimit 1 696 098 (pesëdhjetë e një milionë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e nëntëdhjetë e tetë) lekë.
 4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 51 696 098 (pesëdhjetë e një milionë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e nëntëdhjetë e tetë) lekësh, të përballohet, përkatësisht, 36 696 098 (tridhjetë e gjashtë milionë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e nëntëdhjetë e tetë) lekë nga llogaria “Fondi i shpronësimeve”, në Bankën e Shqipërisë, dhe 15 000 000 (pesëmbëdhjetë milionë) lekë nga buxheti i Bashkisë Belsh.
 5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i vitit 2016, miratuar për Ministrinë e Zhvillimit Urban.
 6. Shpronësimi të fillojë në datën e botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare.
 7. Pronarët e përmendur në listën që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Bashkisë Belsh.
 8. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Elbasan, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Belsh, të fillojë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën treguese të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe të bëjë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.
 9. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Elbasan të pezullojë të gjitha transa-ksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën treguese të regjistrimit dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.
 10. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Zhvillimit Urban, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Elbasan dhe Bashkia Belsh për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi



TË DHËNAT MBI LISTËN EMËRORE E PRONARËVE DHE PRONAVE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR OBJEKTIN: “ANSAMBLI I RILINDJES URBANE BELSH”, BASHKIA BELSH
1. OBJEKTET QË JANË NË KURORËN E LIQENIT TË BELSHIT ME CERTIFIKATË PRONËSIE (Për objektet e banimit, shërbimit dhe truallin)

Nr.	Emër, atësia, mbiemër	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Sipërfaqja e objektit të banimit (m²)	Sipërfaqja e truallit (m²)	Sipërfaqja e objektit të shërbimit (m²)	Çmimi i objektit të banimit (lekë/m²)	Çmimi truall (lekë/m²)	Vlera e objektit të shërbimit sipas situacionit (lekë)	Vlera e objektit të banimit (lekë)	VLERA E AMORTIZIMI PËR NDËRTHESAT (Koha e vënies në funksion 20-vjet/1% në vit)	Vlera e truallit (lekë)	Vlera totale e truallit, objektit të banimit dhe shërbimit (lekë)	Dokumenti i pronësisë
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15
1	CAUSH ISLAM TAFANI	1147	30/36	0	196.6	125.5	32,335.00	234	1681290.72	0	0	46004.4	1727295.12	Certifikatë pronësie
2	BASHKEPRONARE, JORGO QAMIL KUQJA, ANA BASHKIM KUQJA	1147	30/37/2		49.88	36.98	32,335.00	234	643,766.88	-	-	11,671.92	655,438.80	Certifikatë pronësie
3	LAVDIJE ALI SENIA	1147	30/10/2			20.00	32,335.00	234	498,757.25	-	-	-	498,757.25	Certifikatë pronësie
4	LAVDIJE ALI SENIA	1147	30/31		166.00	70.00	32,335.00	234	1,143,314.40	-	-	38,844.00	1,182,158.40	Certifikatë pronësie
5	ZYBER HALIT KUQJA	1147	30/37/1		146.02	122.12	32,335.00	234	1,735,323.84	-	-	34,168.68	1,769,492.52	Certifikatë pronësie
6	FASLLI KARAFIL PIRE	1147	30/38		49.2	49.2	32,335.00	234	1,374,784.80	0	0	11,512.80	1,386,297.60	Certifikatë pronësie
7	NADIRE HAJDAR ALLANI	1147	275/50		61.40	35.30	32,335.00	234	891,012.00	-	-	14,367.60	905,379.60	Certifikatë pronësie
8	BUJAR HYDAJET URUÇI	1147	30/6	216.00		216.00	32,335.00	234	2,847,347.52	6,984,360.00	#####	-	8,434,835.52	Certifikatë pronësie
9	ADEM JONUZ MUÇA	1147	30/39		416.00	305.40	32,335.00	234	3,543,537.60	-	-	97,344.00	3,640,881.60	Certifikatë pronësie
10	PETRIT ZYLYF LIÇI	1147	30/78/1 (30/28)		50.00	50.00	32,335.00	234	1,028,336.16	-	-	11,700.00	1,040,036.16	Certifikatë pronësie
11	BULE AXHEM TAFANI	1147	30/20			25.08	32,335.00	234	539,140.32	-	-	-	539,140.32	Certifikatë pronësie
12	ARISTIDHIS MESUT GJOLENA	1147	30/21			25.08	32,335.00	234	492,395.52	-	-	-	492,395.52	Certifikatë pronësie
13	HAJRIE MYSLIM HYSA	1147	30/25			48.64	32,335.00	234	887,339.04	-	-	-	887,339.04	Certifikatë pronësie
14	BASHKEPRONARE, ASLLAN GANI PEQINI, BURBUQE YZEIR PEQINI	1147	30/56		56.93		32,335.00	234		-	-	13,321.62	13,321.62	Certifikatë pronësie
15	BASHKEPRONARE, ASLLAN GANI PEQINI, BURBUQE YZEIR PEQINI	1147	30/22-ND			25.08	32,335.00	234	427,412.16			-	427,412.16	
16	BASHKEPRONARE, SHABAN SHEFIT KASA, KAFAZE RUSTEM KASA, ASLLAN GANI PEQINI, BURBUQE YZEIR PEQINI	1147	30/23			25.84	32,335.00	234	492,236.16	-	-	-	492,236.16	Certifikatë pronësie
17	SHABAN SHEFIT KASA	1147	30/24		63.13	30.18	32,335.00	234	596,321.28	-	-	14,772.42	611,093.70	Certifikatë pronësie
18	ZEQO ILIAZ SULA	1147	30/5		156.00	96.00	32,335.00	234	1,673,849.76	-	-	36,504.00	1,710,353.76	Certifikatë pronësie
19	ZABIT ZIHNI IDRIZI	1147	30/2-N2 (30/17)		116.00	68.80	32,335.00	234	1,042,347.36	-	-	27,144.00	1,069,491.36	Certifikatë pronësie
20	BASHKEPRONARE, TAULAND SHEFQET HYSA, ILIR SHEFQET HYSA	1147	30/44		52.80	52.80	32,335.00	234	964,312.80	-	-	12,355.20	976,668.00	Certifikatë pronësie
21	JORGO ZANI DUNGA	1147	30/43		251.8	251.8	32,335.00	234	2,585,273.28	0	0	58,921.20	2644194.48	Certifikatë pronësie
22	ARDIAN MESUT HYSA	1147	30/40		186.70	146.90	32,335.00	234	2,278,725.12	-	-	43,687.80	2,322,412.92	Certifikatë pronësie
23	BUJAR DERVISH KUQJA	1147	30/13			38.64	32,335.00	234	589,158.24	-	-	-	589,158.24	Certifikatë pronësie
24	BUJAR DERVISH KUQJA	1147	30/12			32.96	32,335.00	234	564,283.20	-	-	-	564,283.20	Certifikatë pronësie
25	BUJAR DERVISH KUQJA	1147	30/11			21.60	32,335.00	234	657,766.08	-	-	-	657,766.08	Certifikatë pronësie
26	BUJAR DERVISH KUQJA	1147	30/10			66.80	32,335.00	234	1,101,029.28	-	-	-	1,101,029.28	Certifikatë pronësie
TOTALI							32,335.00	234	30,279,060.77	6,984,360.00	(1,396,872.00)	472,319.64	51 696 098	

